



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.299/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi-kryesues, Kujtim Pasuli dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e parashtruara nga kandidatja për Kuvendin e Komunës së Kaçanikut, nga radhët e subjektit politik Vizioni për zhvillimin e Kaçanikut, Floarsa Berisha, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 24.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat e parashtruara nga kandidatja për Kuvendin e Komunës së Kaçanikut, nga radhët e subjektit politik Vizioni për zhvillimin e Kaçanikut, Floarsa Berisha, ZL.Anr.299/2025, ZL.Anr.301/2025, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 27.10.2025, PZAP-i, ka pranuar përmes postës dt. 17.10.2025 ankesat e parashtruara nga kandidatja për Kuvendin e Komunës së Kaçanikut, nga radhët e subjektit politik Vizioni për zhvillimin e Kaçanikut, Floarsa Berisha, ZL.Anr.299/2025, ZL.Anr.301/2025, në të cilat pretendohet se në vendvotimet në komunën e Kaçanikut, me numrat 0706, 0711, 0709, 0715, 0701, 0702, 0703, 0721, 0708, 0704, gjatë numërimit të votave, nuk kanë figuruar votat dhe dyshon që votat e saj i janë tjetërsuar. Gjatë verifikimit dhe rezultateve të publikuara nga KQZ, kishte vërejtur mospërputhje të dukshme të votave në disa qendra të votimit duke pretenduar se në një vendvotim mungojnë mbi 20 vota të dëshmuara.

Në përgjigje në ankesë të KQZ-së, datë 23.10.2025, sqaron se, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese, të kandidatës për kuvendin komunal në Kaçanik, nga subjekti politik Vizioni për Zhvillimin e Kaçanikut, Floarsa Berisha theksohet se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më

01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Me tutje, KQZ thekson se sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe famljarëve të tij, duke theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit.

KQZ, ju njofton se, rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre.

Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Po ashtu, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se palët ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj të paraqitura në ankesë. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.299/2025, ZL.Anr.301/2025, të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët ZL.A.nr.299/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimet ankimore, përgjigjeve në ankesë, konstaton se:

Ankesat janë të pabazuara.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e kandidatës për Kuvend të Komunës së Kaçanikut, nga radhët e subjektit politik Vizioni për zhvillimin e Kaçanikut, Floarsa Berisha, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet se ka pasur parregullsi në qendra të votimit të lartcekura dhe se janë bërë

keqpërdorime të votave, për faktin se nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, përkatësisht nuk ka afruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave në qendrat e votimit të pretenduar të komunës së Kaçanikut.

Po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ-së, vërehet se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruara me ankesë, sepse nuk është pranuar asnjë raport, secili fletëvotim ka qenë i paraqitur në kamerë si dhe në televizor në kohë reale. Nga kjo, nuk kanë marrur asnjë ankesë, qoftë nga vëzhguesit apo vetë anëtarët e subjekteve politike që kanë numëruar secilën tavolinë.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Floarsa Berisha kandidate për asamble komunale e subjektit politik Vizioni për zhvillimin e Kaçanikut është e pabazuar pasi që nuk ka bashkangjitur asnjë provë përkatësisht pretendimi se duhet të ketë rinumërim të votave mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë, në rastin konkret të provuarit e asaj se se duhet të ketë rinumërim, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese, andaj në rrethanat e rastit konkret ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.299/2025, datë 24.10.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.